URDHËR
Nr. 99, datë 2.2.2026

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E ITALISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht.
2. Zonat e prekura me sëmundjen e influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë, janë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3*
1.	Friuli-Venezia Giulia	Udine	Povoletto*
2.	Veneto	Verona	Oppeano*
3.	Veneto	Verona	Isola Della Scala*
4.	Piemonte	Alessandria	Occimiano*
5.	Emilia-Romagna	Bologna	Minerbio*
6.	Emilia-Romagna	Forli' - Cesena	Forlì*
7.	Emilia-Romagna	Parma	Sorbolo*
8.	Lombardia	Lodi	Zelo Buon Persico*
9.	Lombardia	Cremona	Casale Cremasco-Vidolasco*
10.	Emilia-Romagna	Bologna	San Giovanni In Persiceto*
11.	Emilia-Romagna	Modena	Soliera*
12.	Emilia-Romagna	Ferrara	Voghiera*
13.	Emilia-Romagna	Modena	Modena*
14.	Lombardia	Brescia	Seniga*
15.	Piemonte	Novara	Novara*
16.	Lombardia	Mantua	Guidizzolo*
17.	Lombardia	Varese	Olgiate Olona*
18.	Lombardia	Mantua	Ceresara*
19.	Veneto	Venezia	Mira*
20.	Lombardia	Mantua	Goito*
21.	Lombardia	Mantua	Marmirolo*
22.	Lombardia	Mantua	Roverbella*
23.	Verona	Verona	Nogarole Rocca*
24.	Emilia-Romagna	Ferrara	Argenta*

25.	Piemonte	Torino	Front*
26.	Toscana	Pistoia	Agliana*
27.	Veneto	Treviso	Fonte*
28.	Emilia-Romagna	Ravenna	Lugo*
29.	Veneto	Verona	Vigasio*
30.	Veneto	Verona	Verona*
31.	Veneto	Verona	Valeggio Sul Mincio*
32.	Emilia-Romagna	Parma	Noceto*
33.	**Veneto**	**Verona**	**Zimella***

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

3. Certifikata veterinare garanton origjinën e ngarkesës së ardhur.

4. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informon të gjitha subjektet importuese të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht për hyrjen në fuqi të këtij urdhri.

5. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

6. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht, që vijnë nga vendet e sipërcituara, sipas pikës 2 të këtij urdhri.

7. Urdhri nr. 89, datë 29.1.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Italisë”, shfuqizohet.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare**.**

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Fatmir Guri